KUSHTET DHE AFATET E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIEN E LIZINGUT FINANCIAR

1. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Këto kushte dhe afate përcaktojnë marrëdhënien afariste që lidhet nga IFJB Leasing Solution shpk, kompani e regjistruar në Republikën e Kosovës, me numër të biznesit 810070532 dhe me numër fiskal 810070532 (në tekstin e mëposhtëm dhe në të gjitha kushtet plotësuese e quajtur "Institucioni") dhe Klienti, individ, biznes ose në rast të llogarisë së përbashkët, individët privat, të dhënat e të cilëve janë të specifikuara në formularin/ aplikacionin për Lizing (në tekstin e mëposhtëm dhe në të gjitha kushtet plotësuese i quajtur "Klienti").

Raportet afariste ndërmjet Institucionit dhe klientëve të saj lidhen me vullnet të lirë në bazë të/dhe të qeverisura nga këto kushte dhe afate, duke përfshirë produktin dhe shërbimin të cilin e përdor Klienti:

1) aplikacioni për një produkt ose shërbim,

2) çmimoret, tarifat, taksat dhe normat e interesit që zbatohen për produktet/shërbimet e Klientit,

3)kushte të tjera, limite, njoftime, marrëveshje ose informacion që i është dhënë ose do t'i jepet Klientit dhe që janë të zbatueshme për produktet ose shërbimet që do t'i përdorë Klienti. Një kopje e këtij dokumenti mund t'i jepet klientit dhe e njëjta po ashtu prezantohet në zyret tona si dhe mund të shkarkohet edhe nga faqja e internetit e institucionit www.leasing-solution.com. Nëse Klienti ka pyetje shtesë ose ka nevoja të veçanta, të tilla si pengesa në lexim, për lehtësim më të qasshëm dhe për informata shtesë, informacioni i dhënë këtu do të jetë në dispozicion të Klientit në çdo kohë edhe përmes email adrese info@leasing-solution.com ose Klienti mund ta vizitojë degën e Institucionit gjatë orarit të punës. Nëse një pjesë e kushteve dhe afateve është e pazbatueshme për shkak të një kërkese të kërkuar me ligj, kjo nuk do të ndikojë në pjesën tjetër të kushteve dhe afateve të cilat edhe me tutje mbeten në fuqi.

Institucioni mund t'i ndryshojë këto kushte dhe afate në çdo kohë me vendim të brendshëm në mënyrë që t'i marrë parasysh ndryshimet dhe të jetë në përputhje të plotë me kornizën legjislative dhe rregullatorin ose ndryshimet në politikat e saj të biznesit. Çdo ndryshim i tillë do të njoftohet për Klientët të paktën 30 ditë para datës kur ndryshimi hyn në fuqi, megjithatë, një periudhë më e shkurtër njoftimi mund të imponohet me ligj ose me kërkesat rregullative, autoritete të tjera të tilla si gjykatat, Banka Qendrore e Kosovës ose rrethana të tjera përtej kontrollit të institucionit. Ndryshimet do të konsiderohen se kanë qenë të miratuara nga Klienti, nëse Institucioni nuk merr vërejtje ose njoftim me shkrim përpara datës kur ndryshimi hyn në fuqi.

2. Përkufizimet

Afatet dhe kushtet e mëposhtme do të kenë kuptimet e përcaktuara më poshtë, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe.

2.1 Autoriteti

Banka Qendrore e Kosovës, ministritë e qeverisë, agjencitë, policia, gjykatat ose agjencitë e tjera të pavarura në Kosovë.

2.2 Institucioni

Leasing Solution shpk i cili është kompani e regjistruar në Republikën e Kosovës me numër të regjistrimit të biznesit 810070532 dhe me numër fiskal 810070532, pasardhësit e saj ose personat e caktuar nga ajo.

2.3 Aseti

Pasuria e cila financohet nga institucioni, është në emër të institucionit por përdoret nga klienti sipas ligjit për lizing financiar.

2.4 Ditë e punës

Do të thotë dita kur zyra institucionit është e hapur për punë.

2.5 Klienti

Do të thotë konsumatori ose klienti, i cili mund të jetë edhe individ edhe biznes.

3. Mbrojtja e të dhënave (shfrytëzimi i informatave personale)

3.1 Mbledhja e informacionit

Institucioni do të mbledhë informacion për Klientin dhe vendin e tij/saj të punës ose biznesin e tij/saj nëse është i vetëpunësuar, huamarrësit, garantuesit dhe të tjera përmes aplikacionit për llogari ose ndonjë forme tjetër të shërbimit, informatave verbale, agjencisë për monitorimin e kredive dhe gjithashtu nëpërmjet transaksioneve në menaxhimin e llogarisë. Informacioni mund të mblidhet edhe nga palët e treta, agjencitë e parandalimit të mashtrimit dhe të dhënat publike.Institucioni. do të jetë mbajtësi kryesor i këtij informacioni.

3.2 Deklarimi dhe Dakordimi

Klienti deklaron, pranon dhe pajtohet që të gjitha informatat personale që jepen verbalisht ose me shkrim në institucion dhe do të përdoren nga Institucioni për ta kontaktuar Klientin me anë të emailit, postës, telefonit, celularit/SMS-së dhe mënyrave të tjera për qëllime të marketingut për të dhënë njoftim për produktet dhe shërbimet, duke plotësuar kushtet ligjore të kërkuara. Paragrafi më lart nënkupton të drejtën e Institucionit për t'i përdorur të dhënat personale të klientëve, por në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3.3 Regjistri kreditor, rregullatorët dhe parandalimi i mashtrimit

Institucioni ose palët e kontraktuara nga institucioni në kushte respektimi të plotë të konfidencialitetit dhe në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale mund të shpërndajë informacion te Regjistri Kreditor i Kosovës, auditorët e tij, këshilltarët ligjorë, aksionarët dhe autoritetet zyrtare të tilla si Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, që mund t'i përdorin ato për qëllime rregullative, duke përfshirë rolin e tyre të vlerësimit të rrezikut dhe mbikëqyrjes së sistemit institucionit në Republikën e Kosovës. Institucioni është gjithashtu në gjendje të japë informacion për autoritetet si Njësia e Inteligjencës Financiare, policia dhe ATK-ja, nëse kërkohet, sipas kërkesave ligjore për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe mashtrimit ose nëse kërkohet nga ligji në fuqi apo autoritetet relevante.

3.4 Përgjegjësia dhe të drejtat e institucionit

3.1 Institucioni nuk do të jetë përgjegjëse për humbjen, kufizimet e shërbimeve ose vonesat e shkaktuara përtej kontrollit të saj, si p.sh. fatkeqësive natyrore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përmbytje, zjarr, stuhi, ortekëve, ndërprerje te energjisë elektrike, ujit ose ndërprerje të tjera të shërbimeve komunale, ndërprerjen e Internetit apo rastet e luftës, konfliktit, protestat, ndërhyrjet nga autoritetet qeveritare, sulmet kibernetike që nuk mund të zbulohet nga softueri standard i sigurisë, plaçkitjeve të armatosura ose sulmeve të ngjashme.

3.2 Institucioni e informon klientin se kalkulatorët në faqen e internetit të Institucionit janë thjesht për qëllime reference dhe nuk do të thotë se Institucioni është pajtuar ose pajtohet me ndonjë produkt, interes ose afat të maturimit nëpërmjet llogaritjeve të bëra në faqen e internetit të institucionit; për këtë arsye Institucioni nuk do të jetë përgjegjëse nëse Klienti i keqkupton të dhënat e paraqitura ne kalkulatorin ne faqen e internetit.

3.3 Institucioni mund t'i transferojë të drejtat ose detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje tërësisht ose pjesërisht te ndonjë palë e tretë në të cilin rast ajo do ta informojë klientin. Për kontraktimin e një shërbimi ose një pjese të tij (duke përfshirë mbledhjen e borxheve ose dorëzimin e kartelës) te një palë e tretë ofrues i shërbimit nuk ka nevojë të ketë njoftim për klientin;

4. Përgjegjësia e klientit

a) Klienti mbahet përgjegjës për shkeljen e kushteve dhe afateve të përgjithshme;

b) Klienti garanton se ai do të përdorë transaksionet personale ose biznesin e tij personal të autorizuar me ligj dhe në përputhje me ligjet në fuqi, të cilat transaksione do të konsiderohen si personale;

c) Klienti konfirmon se fondet që do të përdoren për transaksionet nuk janë fituar nga ose në lidhje me ndonjë aktivitet kriminal dhe ai/ajo është pronari i fundit përfitues;

d)Klienti pajtohet për ta kompensuar institucionin për të gjitha humbjet, shpenzimet, pretendimet dhe kostot që rrjedhin nga shkelja e kësaj Marrëveshjeje;

e) Klienti do të marrë të gjitha masat për ta zvogëluar ose minimizuar çfarëdo humbje që ndodhë dhe do ta njoftojë Bankën për gabimin pa vonesë.

g) Paratë që i depoziton klienti në llogarinë e institucionit duhet të jenë me origjinë të ligjshme. Banka ku I depoziton

paratë klienti mund të refuzojë ta pranojë një pagesë në llogarinë e Institucionit nëse ka dyshime të arsyeshme se paratë janë të falsifikuara, origjina e tyre është e paligjshme, janë produkt i një veprimtarie kriminale ose do të lehtësojnë veprimtari kriminale, gjë për të cilën banka duhet t'i informojë autoritetet dhe Institucionin. Në rast të gabimit në gjykim, institucioni ose zyrtarët e saj nuk mund të mbahen përgjegjës për asnjë veprim të ndërmarrë në këtë drejtim dhe Klienti pajtohet për ta mbajtur bankën dhe institucionin dhe zyrtarët e saj të padëmtuar dhe nuk do të iniciojë asnjë ankesë për çështje të tilla.

5. Borxhet dhe mbajtja si garanci pagese/kompensimi

Klienti është përgjegjës për pagimin e çdo borxhi në llogarinë e tij/saj. Nëse Klienti ka borxh ndaj institucionit, atëherë Institucioni në çdo kohë ka të drejtë ta ngarkojë këtë obligim në ndonjë nga llogaritë e klientit (përmes përmbaruesit). Institucioni ka të drejtën e kompensimit, që do të thotë se Institucioni mund t'i bllokojë ose t'i mbajë këto shuma dhe t'i përdorë ato për ta paguar borxhin e Klientit ndaj Institucionit. Institucioni gjithashtu mund të regjistrojë peng kundër çdo shume në llogarinë e klientit për ta mbuluar borxhin e tillë.

6. RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE

6.1 Llojet e lizingut

Llojet e lizingut dhe kushtet specifike do t'i jepen klientit varësisht nga kërkesa e tij për produkt. Për çdo informatë specifike rreth llojit të lizingut, klienti do të pranoj informatat para-kontraktuese para nënshkrimit të marrëveshjes. Të gjitha detajet e produktit si shuma, kohëzgjatja, numri dhe vlera e pagesave, norma e interesit, , tarifat administrative dhe destinimi i lizingut janë të përcaktuara në marrëveshjen e cila nënshkruhet nga klienti.

6.2 Kërkesa për lizing

6.2.1 Kur Klienti bën kërkesë për lizing, duhet të shpalosë të gjitha informatat e kërkuara nga zyrtari i lizingut dhe të sigurojë të gjitha dokumentet që mund të ndikojnë në vendimin e Institucionit për të financuar dhe përcaktuar normat e lizingut.

6.2.2 Klienti deklaron/ garanton se:

a) I gjithë informacioni i dhënë në formularin e aplikimit dhe në dokumentet shoqëruese duke përfshirë pasqyrat financiare ose institucionire, deklaratat e të ardhurave, shënimet e biznesit, informacionin për kolateral, dokumentet kadastrale ose të pronës dhe detajet e bashkëshortit/es para dhe gjatë kësaj Marrëveshjeje janë të sakta dhe pasqyrojnë gjendjen reale;

b) Të gjitha dokumentet që i ofrohen Institucionit janë të vërteta, të paindryshuara dhe të azhurnuara dhe pasqyrojnë situatën reale

c) Klienti duhet të jetë i informuar me të gjitha kërkesat e aplikueshme në lidhje me mbrojtjen e ambientit, sigurisë dhe shëndetit sipas ligjeve të kërkuara në Kosovë.

d) Në veçanti, por pa kufizime, ka shpalosur me shkrim për zyrtarin e lizingut çështjet e mëposhtme:

1. të ardhurat e tij/saj, të familjes së tij/saj dhe të gjitha shpenzimet/daljet e rëndësishme të familjes dhe biznesit të tij/saj.

2. detajet e plota të ndonjë kredie (qofshin ato formale ose joformale), ose borxhe të tij/saj, të familjes së tij/saj dhe të biznesit/bizneseve të tij/saj, duke përfshirë edhe situatat ku Klienti është Dorëzan (qoftë në Kosovë ose diku tjetër).

3. Çdo problem financiar që Klienti/familja e tij/saj ka hasur dhe çdo shkelje të fundit nga ai/ajo/ ata në lidhje me ndonjë produkt kreditor.

4. Çdo gjë tjetër që mund të ndikojë në aftësinë e tij/saj për ta shlyer borxhin, duke përfshirë:

4.1 Çdo hetim penal ose civil ose ankesë, duke përfshirë edhe hetimet nga një autoritet publik ose veprimet ligjore ekzistuese ose në pritje kundër tij/saj ose familjes së tij/saj, biznesit ose çdo rrethanë që mund të çojë në një vepër penale ose juridike në të ardhmen.

4.2 Çdo njoftim nga një autoritet publik, duke përfshirë njoftimet e shpronësimit ose çfarëdo në planin e zhvillimit urban apo të tjera që mund të ndikojnë në kolateral.

4.3 Nëse ndonjë ndërtesë ose pjesë e ndërtesës (qoftë në pronësi ose jo) është e paligjshme ose nuk përmbush standardet e ndërtimit.

4.4 Detajet e bizneseve (qoftë nëse janë aktive ose jo) të cilat janë drejtuar nga ose në emër të Klientit/familjes së tij/saj, duke përfshirë bizneset e mbyllura/pasive.

6.3 Kolaterali

6.3.1 Institucioni mund të përdorë si kolateral: të hollat e gatshme, çeqet dhe dokumentet tjera, pasuritë e patundshme dhe pasuritë e tjera. Nëse klienti nuk ka

mjete të mjaftueshme për t'i përdorur si kolateral për një borxh ekzistues ose të pritur, atëherë Institucioni mund të kërkojë nga Klienti që të sigurojë kolateral tjetër dhe të nënshkruajë dokumente shtesë për këtë. Kur Klienti ka disa artikuj të Kolateralit, Institucioni mund të zgjedhë se cilin/ët nga to do t'i shfrytëzoj për t'i shlyer borxhet e klientit ndaj institucionit.

6.3.2 Mbajtja e asetit - Klienti pranon ta ruajë asetin, të mos bëjë asgjë për ta zvogëluar vlerën e tij dhe të mos e shesë ose tjetërsojë atë. Aseti që është inventar i institucionit dhe Institucioni mund të marrë masa të arsyeshme me shpenzimet e klientit për ta zvogëluar në minimum ose për ta parandaluar çdo zvogëlim material të vlerës komerciale të asetit. Si pjesë e këtij detyrimi, Klienti dakordohet për t'i legalizuar me shpenzime të tij/saj ndërtesat ose pjesët e tyre të ndërtuara ilegalisht sa më shpejt që e lejon ligji, dhe për regjistrimin e ndërtesës së legalizuar në kadastër të ofrojë institucionit të gjitha dokumentet përkatëse për t'i mundësuar asaj të bëjë ndryshime në asetin e regjistruar duke pasur përparësi ndaj të drejtave të komunës.

6.3.3 Aseti nuk mund të transferohet te persona të tjerë, të shitet ose të kufizohet me asnjë të drejtë, të zhvendoset, të zëvendësohet, të jepet me qira përveç nëse Institucioni bie dakord me shkrim paraprakisht.

6.3.4 Klienti pranon, nëse Institucioni e kërkon, që të siguroj asetin, që i përmbush kërkesat e Institucionit dhe që zyrtarisht të theksojë interesin e Institucionit në polisat e sigurimit. Klienti pranon që në rast të kompensimeve të pranuara nga sigurimet në rast të humbjes ose dëmtimit të asetit, pa marrë parasysh a është e përmendur Institucioni në polisë, Institucioni ka të drejtë mbi të ardhurat e tij/saj nga ky kompensim. Nëpërmjet kësaj Klienti transferon të gjitha të drejtat e kërkesës te tij/saj ndaj kompanisë së sigurimit te Institucioni.

6.4 Obligimet financiare, obligimet e sigurimit të informatave dhe dokumentacionit

Përveç obligimeve të tjera në Rregullat dhe Kushtet e përgjithshme dhe Marrëveshjen e lizingut klienti duhet:

a) të paguajë tarifat e administrimit dhe të bëjë pagesën e lizingut në llogarinë e institucionit te cekur në marrëveshjen e lizingut të caktuar nga Institucioni në pajtim të plotë me planin e pagesave të bashkangjitur me marrëveshjen e lizingut;

b) të sigurojë të gjitha dokumentet e nevojshme për pagesat e lizingut dhe të veprojë në përputhje me kërkesat e shpalosjes së të dhënave

c) të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, duke përfshirë por pa u kufizuar në marrjen e të gjitha lejeve përkatëse (përfshirë lejet e ndërtimit), standardet e Ligjit për Ndërtimin, standardet e sigurisë, ligjet e regjistrimit të automjeteve dhe ligjet tatimore të cilat ndikojnë në përdorimin e lizingut;

d) të veprojë me ndershmëri dhe në mirëbesim gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes; **(e** të lejojë institcionin të inspektojë dhe monitorojë çdo shpenzim të lizingut nëse ajo është për një qëllim të veçantë. Të monitoroj asetin e lidhur me produktin e lizingut dhe të ofrojë dokumentacionin përkatës në bazë të kërkesës nga Institucioni.

6.5 Bashkëhuamarrës

Duke nënshkruar marrëveshjen e lizingut, bashkëlizingmarrësi gjithashtu siguron dhe merr përsipër obligimet e njëjta dhe është i lidhur me kontratën e produktit sikur të ishte ai/ajo lizingmarrësi, dhe të gjitha referencat për "ai/ajo" ose "lizingmarrësin" do ta përfshijnë edhe "bashkëlizingmarrësin". Bashkëlizingmarrësi nuk është Dorëzan, do të thotë se bashkëlizingmarrësi është i detyruar të bëjë pagesë në qoftë se lizingmarrësi është vonuar në pagesë apo ka bërë shkelje të marrëveshjes.

6.6 Dorëzani

6.6.1garanton që: (i) të gjitha informacionet që i ka dhënë Institucionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në detajet e tij të adresës, janë të sakta dhe që do ta njoftojë Institucionin pa vonesë nëse ndonjë informacion ka ndryshuar, duke përfshirë edhe adresën e tij;

6.6.2 se do ta njoftojë Institucionin nëse është i vetëdijshëm se lizingmarrësi është duke humbur aftësinë për të paguar ose ka gjasa të shkelë kushtet e lizingut ose ka shkelur ndonjë nga detyrimet ose garancitë e lizingmarrësit ose nëse aseti ka gjasa të dëmtohet ose është dëmtuar në ndonjë mënyrë;

6.6.3 bashkëshorti/ja e një Dorëzani individual ka nënshkruar marrëveshje të lizingut ose dokumentet e kolateralit nëse është e përshtatshme ose ka deleguar zyrtarisht të drejtën e Dorëzanit për t'i administruar pasuritë e përbashkëta.

6.6.4 Institucioni do të ketë të gjitha të drejtat për t'i kompensuar, për t'i mbajtur si garanci pagese dhe zbritur të gjitha pasuritë e Dorëzanit si instrumentet e negociueshme të llogarive, fletëngarkesat, aksionet dhe instrumentet e tjera përderisa ato mbahen ose menaxhohen nga Institucioni në të njëjtën mënyrë si ndaj lizingmarrësit nën kushtet e lizingut në lidhje me pasuritë e tij/saj.

6.7 Disbursimi i produkteve

Produkti do të disbursohet, pasi të jetë dhënë kolaterali/mbulueshmëria(në rastet kur aplikohet), të jetë ofruar komplet dokumentacioni i kërkuar nga Institucioni, të jetë aprovuar dhe të jenë marrë nënshkrimet e të gjitha palëve në marrëveshje. Produkti do të disbursohet por shfrytëzimi i mjeteve të atij produkti do të bëhet sipas destinimit konform vendimit të Komitetit te lizingut duke dëshmuar me dokumentacion mbështetës për destinimin. Institucioni do të ketë diskrecion të plotë të vendosë nëse janë plotësuar kushtet për disbursimin e pjesëve të pashfrytëzuara të lizingut dhe të drejtën që të kërkojë edhe plotësimin e kushteve shtesë. Për më tepër, Institucioni nuk garanton lëshimin e ndonjë ose të gjitha pjesëve të lizingut. Institucioni rezervon të drejtën që në çdo kohë dhe nëse e vlerëson të nevojshme ta refuzojë disbursimin/shfrytëzimin e mjeteve për një ose të gjitha pjesëve të produktit.

7. Komunikimi/ndryshimet/udhëzimet

7.1 Ndryshimet

Nëse Institucioni i ndryshon kushtet dhe afatet e përgjithshme, normat e interesit për llogaritë ose tarifat dhe komisionet, Institucioni do të njoftojë klientët për këto ndryshime përmes kanaleve te ndryshme te komunikimit si: faqes se internetit, mesazheve elektronike ne telefon apo emailit duke përdorur adresën e fundit të deklaruar në formularin e aplikimit ose e përditësuar më vonë në institucion.

7.2 Komunikimi

Komunikimet e përgjithshme mund të paraqiten në faqen tonë të internetit http://www.leasing-solution.com dhe/ose në gazetat e Kosovës dhe/ose degët tona.

7.3 Udhëzimet

Institucioni mund të refuzojë të ndjekë udhëzimet e klientit nëse:

a) konsideron që në bazë të ligjit ose nga ndonjë urdhër i ndonjë autoriteti publik nga Institucioni kërkohet të refuzojë një udhëzim të tillë;

b) Institucioni beson se Klienti nuk është duke vepruar me ndershmëri dhe me mirëbesim ose është duke vepruar në mënyrë mashtruese me Institucionin ose të tjerët.

c) Institucioni nuk është e sigurt për autorizimin ose identitetin e klientit;

d) udhëzimet e Klientit nuk janë të qarta, nuk janë të plota ose nuk janë në formën e kërkuar;

f) ka rrethana ekstreme që ndikojnë në Institucion ose në Kosovë ose në tregjet globale financiare.

8. Siguria

8.1 Klienti duhet të bëjë gjithçka që është e mundur për të siguruar që janë respektuar procedurat e sigurisë dhe të dhënat e sigurisë nuk janë zbuluar tek palët e treta.

8.2 Nëse Klienti është biznes, ai është përgjegjës për çdo tentim për keqpërdorim nga cilido nga personeli i tij/saj, kontraktuesit ose dikush që punon me të dhe ai/ajo duhet të zbatojë masat e sigurisë në biznesin e tij/saj për të mbajtur të dhënat dhe detajet e transaksioneve të sigurta dhe për t'i monitoruar transaksionet për ndonjë shkelje të palejuar.

8.3 Në rast se klienti nuk është i sigurt se një telefonatë është nga Institucioni, duhet ta marrë emrin dhe/ose numrin lokal të personit qe e ka kontaktuar dhe ta telefonoj mbrapa për të verifikuar nëse me të vërtetë është kontaktuar nga Institucioni.

Nëse Klienti beson se të dhënat e sigurisë janë kompromotuar, humbur, vjedhur, duhet ta informojë menjëherë institucionin për të ndërmarrë veprimet e parandalimit të keqpërdorimit.

9. Urdhrat nga autoritetet publike

Institucioni mund të zbatojë urdhrat nga palë të treta siç janë gjykata, autoriteti tatimor ose autoritet rregullatore të ngjashme ku ligjërisht kërkohet që ta bëjmë këtë. Institucioni nuk është i autorizuar që të vlerësojë vlefshmërinë e urdhrit dhe nuk është përgjegjëse në qoftë se rezulton se kjo është gabim ose është ndryshuar më vonë.

10. Ankesa ose komente

Në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë, Klienti ka të drejtë dhe është në dijeni se nëse nuk është i kënaqur me shërbimet e ofruara nga Institucioni mund të parashtrojë ankesë tek Shërbimi për Klientë, i cili funksionon në kuadër të Institucionit. Ankesat mund të bëhen përmes:

i) telefonit në numrin 038 752 032 me pagesë
ii) postës elektronike info@leasing-solution.com,
iii) kutive të ankesave në të gjitha degët e institucionit,
iv) adresës postare "Rr. Kroi i Bardhe, Shefqet Shkupi, nr. 8, Prishtinë, Republika e Kosovës", ose
v) të drejtohet personalisht në Institucionit.
vi) Nëse klienti nuk është i kënaqur me trajtimin e ankesës nga Institucioni, klienti ka të drejtë të ankesës në BQK.

11. Klientët që rezultojnë me shtetësi amerikane

duke u bazuar në marrëveshjen e Aktit për Pajtueshmëri Tatimore për Llogaritë e Huaja FATCA (Foreign Account Tax Compliance Act), të gjithë klientët e Institucionit janë të obliguar që nëse kanë shtetësi amerikane, green card ose janë taksapagues amerikan të shpalosin informatat e tilla tek Institucioni.

12. Shpenzimet

12.1 Shpenzimet lidhur me produktet te lizingut: të gjitha kostot e tanishme ose të ardhshme, tarifat ose taksat e krijuara në lidhje me zbatimin e kushteve të lizingut do të paguhen nga Klienti duke iu shtuar vlerës se lizingut ose si pagesë e veçantë në para të gatshme apo përmes llogarisë bankare.

Kostot e ndërlidhura me lizingun përfshijnë por nuk kufizohen ne: shpenzimet e regjistrimit, njoftimin, verifikimin, noterët, avokatët, gjykatat, kopjimin, shpenzimet kadastrale, postën/transportin, personat që realizojnë ankande, agjentët e pronës, vlerësuesit, sigurimin dhe ndonjë shpenzim që Institucioni pëson gjate zbatimit ose ekzekutimit te Kontratës së lizingut.

Për me tepër, çdo shpenzim shtese i ndërlidhur me asetin ose kolateral, taksë apo transaksione te shkaktuara pas përfundimit të lizingut (si shpenzimet e çregjistrimit në kadastra ose të regjistrit të pengut) duhet te mbulohen nga Klienti.

13. Ligji dhe Gjykata

Kushtet dhe afatet e përgjithshme te institucionit do t'i nënshtrohen ligjit dhe gjykatave të Kosovës, edhe pse Institucioni mundet, nëse kështu zgjedh, duke i dhënë Klientit një njoftim të arbitrazhit, ta referojë një kontest të arbitrazhit në Prishtinë, duke përdorur një organ të arbitrazhit të zgjedhur nga Institucioni. Në këto raste do të përdoren rregullat e atij institucioni.

14. Ndërprerja e marrëdhënies afariste

Ndërprerja e marrëdhënies afariste mund të bëhet nga ana e Institucionit në çdo kohë pa pasur nevojë që të jepet ndonjë shpjegim ose arsyetim, me 30 ditë njoftim paraprak. Derisa e njëjta marrëdhënie mund të ndërpritet nga klienti i institucionit në çdo kohë me kusht që ai t'i shlyen të gjitha detyrimet që ka ndaj Institucionit, përveç nëse një gjë e tillë është paraparë ndryshe në marrëveshje me klientin.

Dispozitat përfundimtare

Politika hyn në fuqi ditën kur miratohet nga Bordi Drejtues dhe organi mbikëqyrës i Institucionit.

Prishtinë Prill 2018

LEASING solution

Leasing Solution sh.p.k., Adresa: Kroi i Bardhë, Rr. Shefqet Shkupi, OB1, H1, NR.8
info@leasing-solution.com, www.leasing-solution.com